

LOYOLA-GYMNASIUM – Konkurs për pranimin e nxënësve të rinj për vitin shkollor 2020/2021

Tani e pesëmbëdhjetë vjet Loyola-Gymnasium është duke arsimuar rininë kosovare, sipas standardeve evropiane dhe nën mbikqyrjen gjermane.

Shkolla fillore Loyola ndodhet në zemrën e qytetit të lashtë të Prizrenit, ndërsa shkolla e mesme, e ultë dhe e lartë, si dhe konviktet ndodhen në një fqinjësi të qetë në periferi të Prizrenit.

Kompleksi ynë ofron një mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm.

Rezultatet e shquara akademike tregojnë qartë, si motivimin e nxënësve, ashtu edhe kualifikimet dhe përkushtimet e arsimtarëve.

Të gjithë nxënësit mësojnë **tri gjuhë të huaja**: gjuhë angleze, latine dhe gjermane - diploma DSD 1 dhe DSD 2. Laboratoret moderne për shkenca dhe teknologji informative mundësojnë metoda bashkëkohore në mësimdhënie. Objektet e mëdha sportive, të brendshme dhe të jashtme, mbështesin orët mësimore dhe aktivitetet e kohës së lirë.



Shkolla jonë e muzikës dhe kori ynë, grupi ynë muzikor dhe klubi i vallëzimit stimulojnë hobe kreative. Parlamenti i nxënësve ndihmon në krijimin e përgjegjësisë dhe përvojave demokratike.

Jeta në konviktet tona jo vetëm që është e dobishme, sa i përket mësim-nxënies, por gjithashtu ndihmon në përmirësimin e aftësive sociale, stimulon bashkëpunim dhe pavarësi të nxënësve tanë. Çdo fundjavë konviktorët janë të lirë për të shkuar në shtëpi.

Programet

ndërkombëtare:

Shkëmbime të nxënësve me shkolla gjermane dhe nga Shqipëria, pjesëmarrjet në aktivitete të ndryshme shkollore dhe jashtëshkollore janë poashtu pjesë e programit tonë. Pas shkollimit të mesëm të ne, nxënësit e përkushtuar kanë mundësinë të fillojnë një aftësim profesional ose të përfitojnë nga bursat për studime në Gjermani. Bashkëpunimi ynë me Universitetin e Siegen në Gjermani ua lehtëson shumë studimet e tyre atje.

Këto e shumë të tjera mundësojnë arsimimin evropian në Kosovë. Regjistrimi ka filluar.

Apliko tani!

Tek ne mund regjistrohen **nxënës në klasën e parë, të gjashtë e të dhjetë**. Për nxënësit e klasës së 6-të e 10-të ofrojmë mësim përgatitor, të shtuneve gjatë muajve prill, maj dhe qershor. Edhe pse jemi organizatë jofitimprurëse, nëse vërtetohet që familja nuk është në gjendje të paguajë shkollimin dhe fëmijët e tyre janë të zellshëm e të përkushtuar, atëherë ofrohet përkrahje sociale financiare.

Dokumentet mund të sillen në administratën e shkollës, çdo ditë pune prej orës 08.00 deri në orën 15.30.

**Adresa: Rruga e Tranzitit, Petrovë
20000 Prizren, Republika e Kosovës**

Kontakti dhe për më shumë informata:

+383 (0)44 434 087 - alg-info@alg-prizren.com - www.alg-prizren.com